

**S T A T U T I**  
**SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“SARANTA ENERGJI” SHPK SARANDE**

Themeluesit qe firmosin,

Personi juridik i poshtëshënuar me date 10 Janar 2018;

Shoqëria **“ALB BB AUDITING”** ShPK e regjistruar si person juridik ne QKR me NIPT K31517001I me datës 25/02/2003, përfaqësuar nga administrator/ortak z. Lavdimir Fusha, i biri i Halimit , i datëlindjes 28.10.1957, me identitet nga letërnjoftimi F71028072M, administrator/ortak znj. Elmira Fusha e bija e Perlatit , e datëlindjes 01.02.1965, me identitet nga letërnjoftimi G55201070M, si edhe Ortak znj. Lisjana FUSHA, e bija e Lavdimirit , e datëlindjes 22.02.1987 me identitet nga letërnjoftimi I75222067J, madhor dhe me zotësi te plote juridike për te vepruar, ne mbështetje te vendimit te ortakeve **Nr. 1, date 10.01.2018,**

*si edhe*

Shoqëria **“Qendra e Vlerësimit dhe Zhvillimit te Pasurive Ujore”** ShPK e regjistruar si person juridik ne QKR me NIPT L23318201A me datës 18/09/2012, përfaqësuar nga ortaku i vetëm njëkohësisht edhe administrator z. Eduard Nallbani, i biri i Muhametit, i datëlindjes 13.06.1979, me identitetin te letërnjoftimi H90613054F, madhor dhe me zotësi te plote juridike për te vepruar; ne mbështetje te vendimit te Ortakut te Vetem , **date 10.01.2018,**

Bazuar me vullnet e lire dhe ne përputhje me ligjin Nr.9901 date 14/04/2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), si edhe tërësisht të ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", si edhe Kontratës se Bashkimit te Përkohshëm te Shoqërive nr. 1619 rep, nr. 384/2 kol., te datës 08/04/2016 te te dy themeluesve, si edhe Legjislacionit Zbatues ne Fuqi në Republikën e Shqipërisë, vendosen te hartoi këtë Statut-Rregullore te shoqërisë, ne baze te kushteve qe vijojnë:

**Kreu I**

**OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, RREGJIMI JURIDIK**

**Neni 1.**

Shoqëria ka për objekt te veprimtarisë se saj:

1. Ndërtimi, Prodhim, Tregtim, Furnizimi Publik me Pakice, të Energjisë Elektrike. Shfrytëzimi Hidroenergetik i Lumit Bistrica, Kanali i Cukës, Sarandë, nëpërmjet Hidrocentralit "SARANTA", në bazë të (nenit 49) "Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese" konfirmuar edhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 2881/14 prot te datës 30.11.2017, si edhe tërësisht të ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", si edhe legjislacionit zbatues në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2.**

**Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë**

Ortaket vendosen qe shoqërinë ta emërtohet:

- 2.1. "SARANTA ENERGJI".
- 2.2. Selia Juridike e Shoqërisë do të jete "Hydrocentrali Saranta, Kanali i Cukës, Sarandë, Shqipëri.

**Neni 3.**  
**Regjimi Juridik**

- 3.1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.
- 3.2. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
- 3.3. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**Kreu II**  
**TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**  
**Neni 4**

- 4.1. Shoqëria ka të drejte të lidhe marrëveshje dhe të nënshkruaje kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj, vetëm pasi të jete marrë vendimi i ortakëve, si edhe vetëm për qëllimin e objektit të veprimtarisë;
- 4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale;
- 4.3. Shoqëria përgjigjet ndaj të tremeve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.
- 4.4. Ortaket kanë të drejta të bëjnë propozime, si dhe emërojnë e shkarkojë administratorin ose administratoret, punonjësit, ekspertin kontabël apo likuidatorët.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja**

- 5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat të caktuar.

**Kreu III**  
**KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**  
**Neni 6**

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jete 100 leke. I gjithë kapitali i shoqërisë prej 100 leke është i ndare në 2 (dy) kuota.  
Ky kapital themeltar i shoqërisë, është në këtë pjesëmarrje;
  1. Shoqëria "ALB BB AUDITING" zotëron 1 (një) kuota me përqindje pjesëmarrje 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar e barabartë në vlerë me 50 leke.
  2. Shoqëria "Qendra e Vlerësimit dhe Zhvillimit të Pasurive Ujore" zotëron 1 (një) kuota me përqindje pjesëmarrje 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar e barabartë në vlerë me 50 leke.
- 6.2. Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrin Ortaket.

**Kreu VI**  
**DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE**  
**Neni 7**



- 7.1. Shoqëria fiton Personalitet Juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ushtron aktivitetin e saj pas regjistrimit si subjekt tatimpagues.
- 7.2. Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, si dhe emri i Ortakeve duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet dhe dokumentet që nxjerr kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të treta.
- 7.3. Organet kryesore të Shoqërisë janë: Asambleja e Ortakeve, Administratori dhe eventualisht Eksperti Kontabël, si edhe Drejtuesi Teknik.
- 7.4. Ortaket e Shoqërisë kanë të drejtë të kryejnë çdo lloj veprimi që ligji i njeh Asamblesë së Ortakeve.

**Kreu V**  
**ADMINISTRIMI**  
**Neni 8**

- 8.1. Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator i vetëm që është z. Ferhat MINGA .
- 8.2. Administratori i vetëm i shoqërisë do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 5 vjeçare.
- 8.3. Administratori i vetëm i ka të gjitha të drejtat e fuqitë për drejtimin e zakonshëm të Shoqërisë, me qellim arritjen e objektivave të saj.
- 8.4. Administratorit të vetëm i takon firma e lire dhe përfaqësimi i Shoqërisë ndaj të treta në veprime, procedura dhe seanca gjyqësore ose administrative, si dhe pajtime e kompromise, pasi të ketë marrë vendimin e asamblesë.
- 8.5. Administratori është përgjegjës, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të treta për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo dëme të kryera gjatë ushtrimit të detyrës.
- 8.6. Kompetencat kryesore të administratorit në Shoqëri janë:
  - 8.6.1. Të hartojë planet e llogarive ekonomike.
  - 8.6.2. Të hartojë akte normative që përcaktojnë raportet në gjirin e Shoqërisë, duke përfshirë kuadrin e personelit.
  - 8.6.3. Të përfaqësojë Shoqërinë me të treta në të gjithë veprimtarinë e saj.
  - 8.6.4. Të përcaktojë strukturën e aparatit të Shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
  - 8.6.5. Të përzgjedhë ekspertet kontabël dhe anëtarët e komisionit të likuidimit.
  - 8.6.6. Të përcaktojë numrin e punonjësve të Shoqërisë dhe pagat e tyre.

**Kreu VI**  
**VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE**  
**Neni 9**

- 9.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht —■ viti i parë i regjistrimit të shoqërisë që nis nga data e regjistrimit të saj në QKB.
- 9.2. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Ortaket.
- 9.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.4. Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar, i emëruar për tre vite financiare, me mundësi rizgjedhje, nga Ortaket.
- 9.5. Shkarkimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, në rast

se vërehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyrës.

**Kreu VII**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI SHOQERISE**  
**Neni 10**

- 10.1. Shoqëria mund të priset në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të drejtave për të ushtruar aktivitetet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Ortaket.
- 10.2. Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Ortaket emërojnë një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.
- 10.3. Në fund të procesit të likuidimit, Ortaket vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe mbyllje si pjesë të likuidimit.
- 10.4. Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuuesi përkatës, likuidatori ndan kapitalet e mbetura për Ortaket.

**Kreu VIII**  
**DISPOZITA TE FUNDIT**  
**Neni 11**

- 11.1. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do t'i bëhet referim LIGJ Nr.9723, datë 3.5.2007, ndryshuar me Ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT", si edhe Ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), si dhe legjislacionit koherent.
- 11.2. Ky Statut hartohet në katër kopje, secila me të njëjtën vlerë ligjore. Njëra prej kopjeve ruhet në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

Shoqëria "ALB BB AUDITING" ShPK TIRANE  
me NIPT K31517001I  
përfaqësuar nga ORTAKET



Lavdimir FUSHA

*Lavdimir Fusha*  
*Fusha*

Elmira FUSHA

*Elmira Fusha*  
*si edhe*

Lisjana FUSHA

*Lisjana Fusha*  
*Fusha*

Shoqëria "Qendra e vlerësimit dhe Zhvillimit të Pasurive Ujore" ShPK  
me NIPT L23318201A  
përfaqësuar nga ortaku dhe administratori

Eduard Nallbani

